

Leter punesimi për punojës të huaj jashtë UE në bazë të ligjeve në fuqi

I Nderuar zotëri

.....
ruga.....nr.komuna e (provinca.) kodi i postës
.....

lokaliteti më datë .../.../...

Objekti: Kontrata e punës, ndërmjet ndërmarrjes apo pronarit të punës
zotit.dhe punojësit zotit.

Sipas asaj që parashikon ligji aktual dhe CCNL (kontrata kolektive kombëtare e punës)

Për sektorin, për faktin që ju keni deklaruar nën përgjegjësinë tuaj të
plotë që:

- Posedoni një kartë lejeqëndrimi të rregullt - ose—
- Posedoni një lejeqëndrimi që ju jep mundësinë e një punë në varësinë e dikujt tjetër ,që është e vlefshme deri më.../.../... - ose -
- Keni paraqitur kërkesën për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit që ju lejon të punoni dhe të keni një vërtetim (riçevutë) që vërteton se ju keni qënë në policinë e rrethit ku ju banoni (në kuesturë)

Ju informojmë se ju do të punësoheni nga ne me këto kushte:

1. Data e fillimit të raporti të punës më .../.../...

2.Mënyra dhe kohëzgjatja e kontratës: me kohë të pa përcaktuar apo sipas ligjit në fuqi të artikullit....të dekretit legjislativ nr. 368 shtatorit 2001 dhe sipas ligjit....në fuqi të CCNL.....për kohëzgjatjen në muajmë me saktësi nga .../.../... për këto arsye.....

3. Kualifikimi, emërimi, niveli-kategoria: Ju do të emëroheni si.....dhe do të shënoheni me kulifikimin e.....në....nivelelin/kategorinë të CCNL.....

4. Paguesa: është ajo e parashikuar nga CCNL* dhe gjithashtu mund ti përshtatet edhe kontratës plotësuese që zbaton ndërmarrja.

5. Periudha e provës: konkordohet që ju duhet të bëni një periudhë prove që zgjat.....(sipas pjesës udhëzuese të ligjit të CCNL). **Në qoftë se punojësi vihet dakord me pronarin e punës, periudha e provës mund të zgjatet, deri më.../.../... sipas artikullit.....në fuqi të CCNL. Gjatë periudhës së provës ju do të kryeni këtë emërim/ këto detyra.....

Gjatë periudhës së provës si ju edhe pronari i punës mund të ndërprisni menjëherë raportin e punës pa ju dashur të jepni një paralajmërim dhe pa ju dashur të paguani kompenisimin zëvendësues.

6. Regjistrimi në librin e matrikullave: Ju jeni ishkuar në librin e matrikullave të ndërmarrjeve, në numrin.....të faqes numër.....

7. Vëndi i punës: Vëndi juaj i punës është në ndërmarrjen tonë që ndodhet.....Eshtë megjithatë i mundësh transferimi në një vënd tjetër ose vënia në punë duke ju dhënë emërim tjetër, sipas asaj që parashikon artikulli 2103 c.c dhe nga kontrata kolektive e aplikuar, për të përmbushur nevoja të ardhshme teknike-organizative e prodhuese.

8. Eprori i drejtpërdrejt dhe raporti me kolegët: për organizimin e punës ju duhet të flisni me zotin....., dhe duhet të ndiqni me rreptësi udhëzimet e dhëna.

9. Kushte të tjera: përsa i përket pagesës, kohezgjatjes së pushimeve, orarit të punës, kohëzgjatjes së paralajmërimit, dhe për çdo gjë tjetër të pa shënuar në këtë kontratë punësimi, vlejnjë e praktikohen normat dhe kushtet e parashikuara nga ligjet aktuale , dhe CCNL.....të kontratimit

dhe rregullave të ndërmarrjes. Ju jeni i detyruar të respektoni normativat dhe rregullat rreth temës së sigurisë, që do tju ilustrohen.

Ju ftojmë të firmosni kopjen e këtij dokumenti si shenjë e pranimi të plotë dhe totale të saj.

Punuesi

Pronari i punës

firma

firma

**nëse parashikohet.*

*** çështje e vlefshme vetëm për CCNL që parashikojnë mundësinë e një zgjatje të periudhës së provës të vendosur që në fillim*

• krahaso "udhëzimet për lezimin e letrës së punësimit" për kuptimin e këtyre fjalëve.

Udhëzime për leximin e letrës së punësimit

- Kualifikimi, emërimi, niveli-kategoria:

Emërimi përbën një nga detyrat kryesore që i kërkohen punojësit. Mund të modifikohet nga pronari i punës për nevoja teknike, organizimi apo prodhimi. Në raste modifikimi, pronari i punës duhet ti japë punojësit një tjetër emërim profesional, jo më të ulët se ai që punëtori zotëronte më parë.

Në bazë të karakteristikave që kanë emërimet, punojësit janë të ndarë në katër kualifikime:

- punëtor
- nënpunes,
- kuadro,
- drejtora.

Çdo niveli i përket një shprehje minimum i cili parashikohet nga CCNL në varësi të emërimit Nivelet ose Kategoritë janë të zhvillura në shkallë.

Punojësi me kalimin e kohës mund të arrijë të zotërojë një nivel më të lartë se ai që zotëronte në fillim, sipas CCNL, vetëm në rastin kur pronari i punës i cakton një tjetër emërim punojësit me përberje profesionale në rritje . Në qoftë se punojësi duhet të kryejë emërimet specifike, duhet të bëjë përpara se të fillojë emërimin e ri një vizitë mjekësore, dhe kontrole të herë pas hershme.

Në qoftë se punëtori refuzon të bëjë këto kontrole, pronari i punës nuk arrin të verifikojë aftësitë që ka ai për të punuar dhe kështu mund të mos e paguaj punojësin. Në qoftë se aftësitë e punojësit për të punuar zvogëlohen dhe nuk arrin të kryejë detyrën për të cilën ai është emëruar, në kontratën e nënshkruar prej tij, punojësi duhet t'ja bëjë menjëherë të ditur pronarit të punës në mënyrë të tillë që të bëjë të mundur verifikime të mundshme apo ndërhyrje për zgjidhjen e këtij problemi.

- CCNL, mënyra e bërjes së kontratës, rregullat e ndërmarrjes :

Raporti i punës është i vendosur nga:

- ligji,
- kontrata kolektive, e përbërë nga CCNL (Kontrata kolektive kombëtare e punës) të kategorisë së shënuar në letrën e punësimit, si dhe nga kontratat e ndërmarrjes që përcaktohen nga vetë ndërmarrja.

Rregullat dhe njoftimet e bëra nga ndërmarrja kompletojnë normat e kontratës kolektive. Për shpjegime mbi të drejtat/detyrat e punojësve e të punëdhënësve punëtori mund ti drejtohet direkt zyrës së kuadrit.

Ligjet, kontratat kolektive dhe rregullat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, dhe kështu trajtime (sjellje) të njohura ose të pa njohura më parë mund të mos jenë më. Gjithashtu ka disa kontrata kolektive që ndryshojnë në sektorë dhe reparte të ndërmarrjes, kjo ndodh edhe nga një ndërmarrje në tjetrën, dhe si rrjedhojë ajo që njihet/nuk njihet nga një punëdhënës, ndryshon nga një punëdhënës në tjetrin, kjo varet nga marrëveshjet që aplikon secili prej tyre.

- Kohëzgjatja:

Kontrata e punës mund të jetë me kohë të përcaktuar apo të papërcaktuar.

Kohë e papërcaktuar: raporti i punës mbaron vetëm me dorheqjen apo pushimin nga puna për një shkak mëse të drejtë.

Kohë e përcaktuar: raporti i punës ka të bëjë me një nevojë teknike, organizimi, prodhimi apo zëvendësimi e deklaruar nga pronari i punës në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe mbaron automatikisht në datën e caktuar në letrën e punësimit. Në qoftë se punëtori dhe pronari i punës vihen dakord , kontrata me kohë të përcaktuar mund të zgjatet vetëm një herë – me një kohëzgjatje jo më shumë se tre vjet – ose mund të ripërsëritet edhe më shumë se një herë , në qoftë se në mbarim të çdo kontrate punojësi nuk punon për një periudhë kohe. Kohëzgjatja e kësaj periudhe varet nga kohëzgjatja e parë e këtij raporti.

- Regjistrimi në librin e matrikullave:

Numri i matrikullit është kodi që identifikon punëtorin dhe vjen i shënuar në një libër kontabiliteti (libër matrikulle) që është i detyrueshëm. Regjistrimi duhet të bëhet dhe ti komunikohet të interesuarit në momentin e bërjes së kontratës dhe siguron punëtorin për një raport pune të rregullt.

- Detyrime që kanë të bëjnë me lejeqëndrimin:

Punëtori që zotëron një lejeqëndrim duhet të shkojë herë pas here në drejtorinë e policisë (në kuesturë) në vendin ku banon për të këkuar ripërtëritjen e lejeqëndrimit. Kërkesa duhet paraqitur:

- Te paktën 90 ditë përpara mbarimit të afatit në qoftë se raporti i punës është me kohë të pa përcaktuar.
- Të paktën 60 ditë përpara mbarimit të afatit në qoftë se raporti i punës është me kohë të përcaktuar.
- Të paktën 30 ditë në qoftë se është punë stinore.

Në qoftë se mbaron afati i lejes së qëndrimit dhe punëtori nuk ka paraqitur akoma kërkesën për përsëritjen e saj, pronari i punës nuk mund ta pranoj punëtorin në ndermarrje dhe mund të ndaloj ndërkohë edhe pagesën për punën e bërë. Gjithashtu nëse lejeqëndrimi ka dy muaj që i ka mbaruar afati praktika për ripërtëritjen e saj mund të refuzohet. Vëtëm pas disa vitesh me leje qëndrimi të rregullt në Itali mund të bëhet kërkesa për lëshimin e kartës së lejes së qëndrimit me kohë të pa përcaktuar. Karta e lejes së qëndrimit me kohë të pa përcaktuar nuk ripërtërihet dhe mund të përdoret edhe dokument identifikimi personal. Karta e lejes së qëndrimit ka avantazhe të ndryshme si për shembull: hyrjen në Itali pa pasur nevojën e vizës, bërjen e shume punëve ligjore përveç disa punëve të ndalura nga ligji italian të huajve, të ruajtura këto vetëm për italianët, si hyrja, në shërbimet administrimit publik etj.

- Detyrim i mbajtjes së sekretit /besimi :

Gjatë raportit të punës punëtori nuk mund të punojë për një tjetër pronar pune edhe gjatë periudhave kur puna është e ndaluar për pushime, festa, leje ose për çdo gjë tjetër. Punëtori nuk mund të punojë kështu për një tjetër pronar pune që merret me të njëjtin aktivitet, dhe nuk duhet të tregojë informacione që i përkasin organizimit dhe metodave të prodhimit të ndërmarrjes që ai varet ose më saktë nuk mund ti përdorë ato për ta dëmtuar atë.

- Orari i punës:

Në letërën e punësimit gjenden numri i orëve që punëtori duhet të kryejë, dhe shpërndarja e tyre në ditë. Pronari mund ta ndryshojë atë edhe përsa i perket numrit e shpërndarjes në ditë, sipas mënyrave që parashikojnë ligjet e CCNL.

Orët e punës që i kalojnë orarit normal të parashikuar janë të quajtura orë suplementare dhe paguhen më shumë siç është e parashikuar nga CCNL, e cila përcakton edhe sasinë maksimale të tyre, që ndryshon në nivel ndërmarrjes. Në fillim të orarit të punës punëtori duhet të gjendet në vëndin e punës dhe të fillojë punën. Në qoftë se punëtori është me vonesë të pa justifikuar pronari i punës mund ti heqë nga rroga kohën që ai nuk ka punuar, sipas mënyrave të parashikuara nga kontrata kolektive kombëtare dhe të marri masa disiplinore.

Në qoftë se punëtori nuk shkon në punë, duhet të kërkojë më parë lejet dhe pushimet

Në qoftë se punëtori qëndron në shtëpi se është i sëmurë apo ka pësuar ndonjë fatkeqësi duhet të njoftojë sa më parë të jetë e mundur pronarin e punës dhe të justifikojë mungesën me dokument të dhënë nga mjeku për pronarin e punës. Në qoftë se emërimi i punojësit është "punëtor" duhet ti bëjë të ditur mungesën e tij në punë edhe INPSit brënda 2 ditësh mbas lëshimit të certifikatës nga mjeku.

Punojësi gjatë periudhës që është sëmurë duhet të rrijë në shtëpi nga ora 10 deri në orën 12 dhe nga ora 17 deri në orën 19 gjatë gjithë ditëve të javës, në mënyrë të tillë që ti japë mundësinë pronarit të punës të bëjë kontrolle mjeksore. Në qoftë se punojësi ndryshon vëndqëndrim apo i duhet të dalë gjatë këtyre orareve duhet më parë të njoftojë ndërmarrjen.

- Periudha e provës:

I ashtëquajtur "pakti i provës" përkufizon një periudhë kohe në të cilën si pronari i punës ashtu dhe punojësi mund të ndërpresin raportin e punës pa pasur nevojën e një paralajmërimi apo një justifikimi që ndërprerja e raportit të të punës vjen si pasojë e një motivi të justifikueshëm. Kohëzgjatja maksimale e periudhës së provës përcaktohet nga CCNL por mund të shtohet, kjo nëpermjet një marrëveshje vetjake në situata të veçanata. Në linja të përgjithshme në qoftë se gjatë periudhës së provës punojësi nuk punon për festa, sëmundje, fatkeqësi, në asitënzë e tjera. – periudha e provës është anuluar deri në rifillimin e rregullt të punës.

- Paralajmërimi dhe kompesimi:

Në qoftë se punojësi i punësuar me kohë të pa përcaktuar jep dorheqjen duhet të njoftojë pronarin e punës me një letër të shkruar dhe duhet të punojë akoma për një kohë të shkurtër të quajtur "paralajmërim". Kohëzgjatja e paralajmërimit përcaktohet nga CCNL. Gjatë periudhës së paralajmërimit, punëtori paguhet dhe duhet të respektojë të gjitha detyrat që i takojnë. Në qoftë se punëtori nuk punon apo nuk mbaron deri në fund këtë periudhë, pronari i punës mund ti heqë nga rroga një shumë parash e quajtur "Kompensim të paralajmërimit" që i korrespondon lekëve përsa i perket ditëve të paralajmërimit. Gjithashtu pronari i punës duhet të respektojë ditët e

paralajmërit nëse pushon nga puna një punojës me kontratë të pa përcaktuar, me përjashtim të rasteve të rënda të shënuara këto edhe nga ligji, që justifikojnë ndërprerjen e raportit të punës pa paralajmërim.

– Pagesa:

Është rroga që një punojës fiton dhe përbëhet nga elementë të drejtpërdrejt, jo të drejtpërdrejt ose të mund të shtyhet.

Elementët e drejtpërdrejt janë të përbërë nga pagesa minimale e detyrueshme e parashikuar nga CCNL e vendosur kjo në lidhje me nivelin që i jepet secilit, nga sjellje të mundëshme të përmirsuara që pronari i punës i jep vetëm disa nga punojësve apo të gjithëve punojësve të tij (çmime etj.), nga shtime rroge , kompensime të parashikuara nga CCNL në varësi të mënyrave të shërbime (shtime për punën jashtë orarit, festa, apo për punën natën etj.) ose nga kontratime(bisedime) kolektive të te ndërmarrjes(çmime për rezultate të dhëna, rritje dhe shtime kombëtare etj.).

Elementët jo të drejtpërdrejt janë të përbëra nga pagesa që merret edhe kur punëtori nuk shkon në punë si për shembull, kur është me pushime, me leje të paguaj, në festa, sëmundje apo fatkeqësi në vëndin e punës.

Elementët shtesë janë të përbërë nga pagesa e muajit të trembëdhjetë dhe nga shtesa të mundëshme, që shtohen në rritje gjatë raportit të punës në kuota mujore por që punojësi i merr vetëm një herë në vit, dhe nga TFR që shtohet vazhdimisht në kuota muore por që punojësi i merr vetëm nëse raporti i punës mbaron.

Punojësi gjen përmbledjen e elementëve të drejtpërdrejt, jo të drejtpërdrejt, dhe shtesë në letrën e pagesës, që pronari i dorëzon me rrogën.

Në letrën e pagesës punojësi gjen pagesën "lorido" që i korrespondon shumës së elementëve të përveçëm të parashikuara nga kontrata kolektive. Pronari i punës heq nga rroga taksat që i paguan shtetit italian dhe heq kontributet për pensionin e punojësit. Ajo që mbetet është "neto" rroga që merr punojësi.

– Vëndi i punës ,vajtja me shërbim, transferimi:

" Transferimi" është ndryshimi i qëndrueshëm i vëndit të punës (vënd ku punojësi kryen shërbimet për të cilën ai është punësuar) që në fillim.

Vajtja në shërbim është një shërbim jashtë vëndit të punës që për një periudhë kohe.

Pronari i punës mund të vendosë për këto ndryshime (transferimi apo vajtja në shërbim) në qoftë se ka nevojë ndërmarrja dhe punëtori nuk mund ti refuzojë , por mund të ketë kompesime (si për shembull çmime ose rrogë shtesë) të parashikuara nga CCNL ose nga kontrata e ndërmarrjes.

– Siguria në punë:

Punojësi duhet të bëjë punën e tij sipas rregullave të sigurisë që i janë përshkruar dhe duhet të përdorë mbrojtjen që i është dhënë. Në qoftë se punojësi nuk zbaton rregullat e sigurisë vë në rrezik shëndetit e tij dhe pronari i punës mund të ndërhyjë duke përdorur disiplinën (si për shembull duke vënë gjobë, duke tërhequr vëretjen, deri në pushimin nga puna dhe mos dhënien e rrogës) .Në qoftë se ka situata rreziku për punojësin apo për kolegët, duhet të njohtohet menjëherë pronari/drejtori, për të bërë të mundur ndërhyrjen e menjëhershme.

– Eprori I drejtpërdrejt dhe marrëdhëniet me kolegët:

Për të pasur të gjitha informacionet se si duhet të kryejë detyrën, punojësi duhet të flasë me eprorin . Për të pasur sqarime rreth

pagesës ekonomike dhe rregullave apo për probleme me kolegët apo me vetë shefat punjësi mund ti drejtohet drejtpërdejt zyrës së kuadrit.

Drejtoria e ndërmarrjes.